

urdhëruan që të niseshin mbrapa në qytet. Mbetjet mortore të Agronit u gjetën në afërsi të Glllogocit/Glogovac. I varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac më 15.08.2005.

Burimet: deklarata A.I, FDH-5517; deklarata H.A, FDH-12269; deklarata S.H, FDH-33072; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; AIS, *Zona...*, 66, FDH-16913.

Duško (Veljko) Patrnogić

(17.02.1952, serb nga Hoça e Madhe/Velika Hoça, komuna e Rahovecit/Orahovac, teknik mjekësor, tre fëmijë)

Aleksandar (Stanoje) Stanojević
(13.03.1956, serb nga Zvezdara [Beograd], mjek, dy fëmijë)

Ushtarë të UÇK-së kanë hyrë në Shtëpinë e Shëndetit [**Rahovec/Orahovac**] rreth orës 19:00, në datën 17.07.1998. Hyrën me Abdullah Bugarin, djalin e receptionistit Zijajdinit. Menjëherë pyetën për mjekun Aca. Ai gjendej në ordinancën e tij. Te ai ishte edhe Duško. Doktorit ushtarët i kërkuan pistoletën dhe ai e dorëzoi menjëherë. Pastaj, e morën jashtë godinës. Pastaj, e morën Duškon në pyetje, e rrahën dhe, në fund, edhe atë e morën me vete. Që të dy i çuan te vendi i quajtur *Koritë Uji/Pojilo*, ndërkaq, më vonë, në burgun e Malishevës/Mališevo, ku ishin edhe serbë të tjerë të burgosur. Ushtarët i keqtrajtuari të burgosurit, u mëshonin me çizme dhe kondakë. Në mbrëmjen e datës **18.07.1998**, ushtarët i nxorën që të dy në grupin me Jovan Lukićin dhe i dërguan në pyll pranë **Malishevës/Mališevo**. I çuan te disa gropa të hapura afro 50 metrash larg rrugës së asfaltuar. Jovani ka shpëtuar në rrethana të pasqaruara deri më sot. Familjarët nuk dinin asgjë për fatin e tyre për një kohë të gjatë. Në muajin prill të vitit 2005, mbetjet e tyre mortore janë gjetur në varrezën masive pranë spitalit të Malishevës/Mališevo. Duško u varros në Beograd më 13.10.2006. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Aleksandrit në Varrezat e Reja të Beogradit.

Burimet: deklarata V.A, FDH-401; deklarata M.B, FDH-422; deklarata J.L, FDH-455; deklarata Ž.P, FDH-457; deklarata V.A,

FDH- 464; deklarata N.G, FDH-465; deklarata M.D, FDH-470; deklarata J. S, FDH-3899; deklarata V.V, FDH-5514; deklarata N.N, FDH-5519; deklarata S.V, FDH-5691; deklarata S.V, FDH-5696; deklarata Z.G, FDH-18940; deklarata S.P, FDH-20099; FDH, *Registri...*, FDH-5515; FDH, *Registri i kufomave...*, FDH-12986; AIS, *Zona...*, 62, FDH-16913; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; AFPRRZHKem, *Registri i personave...*, FDH-16116.

Đorđe (Antonije) Đorić

(7.06.1970, serb nga Rahoveci/Orahovac, vozitës)

Si vozitës, Đorđe ishte i angazhuar në transportimin e ushqimeve për hotelin *Park*. Një muaj para sulmit kundër **Rahovecit/Orahovac**, në qytet ka arritur grupi i ri i policisë me tre autobusë me targat e qytetit të Pirotit. Flinin dhe ushqeheshin në hotelin *Park*. Në mbrëmjen e datës 17.07.1998, Đorđe ishte duke e çuar me makinë fqinjën shtatzëne Daliborka Stolić në Shtëpinë e Shëndetit. Me ta ishte edhe bashkëshorti i Daliborkes, Njogoši. Pak para Shtëpisë së Shëndetit, makina e tyre u ndal nga një grup ushtarësh të UÇK-së. E dinin se Đorđe i kishte dy vëllezër në polici. I mbajtën në rrugë për afro 20 minuta dhe, më pas, i dërguan në Shtëpinë e Shëndetit. Đorđe ishte i mbyllur në një nga dhomat. Kohë pas kohe, atë e nxirrnin në korridor, e merrnin në pyetje duke e rrahur. Në mbrëmjen e ditës tjetër [**18.07.1998**], ushtarët e UÇK-së, të cilët thanë të ishin nga *Drenica/Drenica*, e nxorën Đorđen nga godina. E çuan në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Herën e fundit atë e shihnin të gjallë më 26.07.1998, kur me serbë të tjerë të burgosur, kryesisht nga Opterusha/Opteruša dhe Retia/Retimlje [të shikohen regjistrimet], u dërguan në drejtim të Prishtinës/Prishtina. Mbetjet mortore të tij u zbuluan në muajin prill të vitit 2005, në varrezat masive në Volljakë/Volujak [Klinë/Klina]. Pas identifikimit të kryer me analizën e ADN-së, familjarët i kanë varrosur mbetjet e tij mortore në Beograd, më 14.10.2006.

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata N.G, FDH-465; deklarata J.S, FDH-3899; deklarata S.B, FDH-5513; deklarata N.N, FDH-5519; deklarata J.S, FDH-5676; deklarata S.S,